Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

*Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 12).*

### 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertët kontabël të licencuar, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2017, 2018, 2019**).

**2.2.2** Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet se xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2017, 2018, 2019**) duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se 50 % e fondit limit që prokurohet.

**2.2.3** Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**

**2.2.4** Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin **2019** dhe **2020** për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

## 2.3 Për kapacitetin teknik:

### 2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** (që i korrespondon vlerës 140,915,835.8 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.  
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** (që i korrespondon vlerës 563,663,343 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes;
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit;
  - iii. Faturat Tatimore (për çdo situacion) sipas legjislacionit tatimor;
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit;
  - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.9.
  
- Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes;
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit;
  - iii. Faturat Tatimore (për çdo situacion) sipas legjislacionit tatimor;
  - iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.9/ Vërtetim realizimi.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- 2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **Kategoria NP-1** (*Punime gjurmimi në tokë*) – **Klasifikimi C**
- **Kategoria NP-5** (*Punime nëntoksore, ura e vepra arti*) – **Klasifikimi C**
- **Kategoria NP-6** (*Diga dhe tunele hidroteknike*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-7** (*Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje*) – **Klasifikimi D**
- **Kategoria NP-12** (*Punime të inxhinierisë së mjedidit*) – **Klasifikimi B**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **Kategoria NS-4** (*Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, ...*) – **Klasifikimi C**
- **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura...*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-9** (*Punime strukturorë speciale*) – **Klasifikimi C**
- **Kategoria NS-16** (*Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*) – **Klasifikimi B**

\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë organeve kompetente në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme - Kodi III.2.B - *Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme urbane (mbetjet që dalin nga punimet) dhe për trajtimin e impjantit të ujërave*, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatat ISO**, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **OHSAS 18001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar
- **ISO 39001** (*Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor*) e përditësuar
- **ISO 27001** (*Për menaxhimin e sigurisë së informacionit*) e përditësuar
- **ISO 8000** (*Për menaxhimin e përgjegjësisë shoqërore*) e përditësuar
- **ISO 3834-2** (*Për menaxhimin e kushteve të cilësisë për shkrirjen e metaleve*) e përditësuar
- **PAS 99** (*Për sistemin e menaxhimit të integruar*) e përditësuar

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Të gjitha çertifikatat

e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.*

### **2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Tuba HDPE/ PN 10; 16; 25 sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike**
- **Tuba Çeliku sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike**

#### **Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

- 1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- 2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shënim:** *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

- 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara
- 4. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 dhe/ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti për produktet e kërkuara.**

### **2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve objekt kontrate, për analizat e mëposhtme:**

- Beton i freskët sipas standardeve SSH EN 206:2013+A1:2016, SSH EN 12350-2:2009 SSH EN 12350-6:2009, ose sipas standardeve të përditësuara
- Beton i ngurtësuar sipas standardeve SSH EN 12390 - 3:2009/AC:2011, SSH EN 12504-1:2009, SSH EN 12390-7:2009 , SSH EN 12504-2:2012 , SSH EN 12504-4:2008 , ASTM

D6760-16 , ASTM D5882-16, ose sipas standardeve të përditësuara

- Çelik sipas standardit SSH EN 6892-1:2016, ose sipas standardeve të përditësuara.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **240** (*dyqind e dyzet*) **punonjës** për periudhën **Dhjetor 2019 – Nëntor 2020**, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.
3. Formularët e deklaramit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (**FDP**) për periudhën e mësipërme.
4. Mandat pagesat e (**FDP**) dhe (**TAP**) për periudhën e mësipërme.

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë me ditë të plota pune për 6 (*gjashtë*) muajt e fundit, stafi inxhinierik si më poshtë:
- Minimuni **2** (*dy*) **Inxhinier Ndërtimi**
  - Minimuni **2** (*dy*) **Inxhinier Hidroteknik**
  - Minimuni **1** (*një*) **Inxhinier Elektrik**
  - Minimuni **2** (*dy*) **Inxhinier Gjeodet**
  - Minimuni **2** (*dy*) **Inxhinier Mjedisi**
- b) Operatori ekonomik duhet të ketë minimum **30** (*tridhjetë*) punonjës të punësuar për 6 (*gjashtë*) muajt e fundit të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (*i ndryshuar*), nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin:
- Teknik ndërtimi - jo më pak se **1** (*një*) punonjës
  - Specialist për montim tubash – jo më pak se **3** (*tre*) punonjës
  - Hidraulik – jo më pak se **5** (*pesë*) punonjës
  - Elektriçist – jo më pak se **3** (*tre*) punonjës
  - Murator – jo më pak se **4** (*katër*) punonjës
  - Karpentier – jo më pak se **4** (*katër*) punonjës
  - Saldator – jo më pak se **4** (*katër*) punonjës
  - Hekurkthyes – jo më pak se **4** (*katër*) punonjës
  - Bojaxhi – jo më pak se **2** (*dy*) punonjës

## Dokumenta Standarde të Tenderit

\* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë me ditë të plota pune për periudhën e cituar më lart.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një) mjek**, të vërtetuar me Kontratë Noteriale Pune (të vlefshme), Urdhër mjeku, Diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit.  
*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.742, datë 06.11.2003, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*
- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një) Ekspert zjarrëfikës**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të pajisur me Liçensë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL.
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën **1 (një) Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse.
- f) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/ dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, punonjës me specialitetin si më poshtë:
- Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për dëmet në mjedis”**.
  - Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave ”**.
- g) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë i cili duhet të ketë eksperiencë pune minimum 15 (pesëmbëdhjetë) vjet dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune (e vlefshme)
  - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera

## Dokumenta Standarde të Tenderit

dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **6 (gjashtë) manovratorë** të mjeteve të rënda, nga të cilët të jenë **2 (dy) automakinistë** dhe **4 (katër) eskavatoristë**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për 6 (gjashtë) muajt e fundit, dhe për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat, ku të pasqyrohet në ekstraktin e shoqërisë ose të qeradhënësit, si dhe duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se objekti është me qera.
- Liçencë nga QKL, (Kodi III.2.B) – Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte...
- Leje Mjedisi e tipit C nga QKL, (Kodi III.1.A) – Magazinimi, ngarkimi...

### **2.3.11 (Makineri, Pajisje)**

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet, mjete dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ mjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 25 ton	jo më pak se 2 copë
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12 – 17 ton	jo më pak se 5 copë
3.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton	jo më pak se 5 copë
4.	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 2 ton	jo më pak se 4 copë
5.	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton	jo më pak se 3 copë
6.	Fadrome me goma	jo më pak se 3 copë
7.	Eskavator me goma 0.25 m3	jo më pak se 4 copë
8.	Eskavator me zinxhir	jo më pak se 4 copë
9.	Autobetoniere	jo më pak se 2 copë
10.	Autobot uji	jo më pak se 1 copë
11.	Rrul	jo më pak se 1 copë
12.	Autobitumatriçe	jo më pak se 1 copë



Dokumenta Standarde të Tenderit

13.	Asfaltoshtruese	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Prerëse Asfalti	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Rimorkiator për transportimin e mjeteve të rënda me kapacitet min 20 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
16.	Çekic pneumatik	<i>jo më pak se 2 copë</i>
17.	Betoniere 0.33 m <sup>3</sup>	<i>jo më pak se 4 copë</i>
18.	Kallëperi	<i>jo më pak se 300 m<sup>2</sup></i>
19.	Pompë uji	<i>jo më pak se 2 copë</i>
20.	Vibrator	<i>jo më pak se 4 copë</i>
21.	Matrapik	<i>jo më pak se 4 copë</i>
22.	Motogjenerator	<i>jo më pak se 3 copë</i>
23.	Makine per ngjitje tubash PE	<i>jo më pak se 2 copë</i>
24.	Saldatrice	<i>jo më pak se 4 copë</i>

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 150 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 4 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 15 copë*
- Kullë ndricimi – *jo më pak se 1 copë*
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi – *jo më pak se 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – *jo më pak se 5 copë*

□ **Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Çertifikatën e transportit nga autoritetet përkatëse (*të vlefshme*) dhe Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat.
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Çertifikatën e transportit nga autoritetet përkatëse (*të vlefshme*) dhe Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat.
- 3- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qira.
- 4- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes.

- 5- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes.

**Shënim:** *Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira, të paraqiten: 1. Kontratë noteriale qiraje/ huapërdorje me emër objekti dhe me afate të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve dhe/ ose; 2. Kontrate noteriale qiraje/ huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe/ ose pajisjet e marra me qira.*

- 6- Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera, nuk duhet të jenë të deklarurara në procedura të shpallura fituese dhe/ose në procedura të cilat kanë lidhje me procedurat e rindërtimit të objekteve të dëmtuara si pasojë e termetit të 26 Nëntor 2019, si dhe të deklarojë vendodhjen e mjeteve, pajisjeve për verifikim nga KVO-ja gjatë vlerësimit (**deklaratë me shkrim nga Administratori i Shoqërisë**)

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.*

- 2.3.12** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera (*Kontrata Noteriale e Qerasë duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se kantieri është me qera.
- Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B)

- 2.3.13** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera (*Kontrata Noteriale e Qerasë duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se kantieri është me qera.
- Leje Mjedisi nga QKL (*përkatëse*) në përputhje me ligjin.

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).**

- 2.3.2** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- **Tuba HDPE/ PN 10; 16; 25**

– Tuba Çeliku

- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s’kualifikim.**

**2.3.14 Afati i kryerjes së punimeve:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

**2.3.15 Në zbatim të nenit 26 të VKM 914 datë 29.12.2014 (të ndryshuar) OE/BO duhet të paraqesë:**

*Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/ investimit.*

❖ **SHËNIME:**

- I. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës oferton/ merr pjesë si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, kandidatët/ ofertuesit duhet t’i përmbahen përcaktimeve të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kandidatët/ ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 e 46 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

- II. **Për të mundësuar njohjen me terrenin dhe objektin ku do të realizohen punimet objekt prokurimi, nëse kërkohet nga Op. Ek. që të kryej një vizitë, Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në terren në datën që do të caktohet me marrëveshje, duke vënë në dispozicion të Op. Ekonomik punonjës të Bashkisë Mat, që do të shoqërojnë të interesuarit për këtë qëllim.**

*\* Për të gjithë Op. Ekonomik ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të cilët nuk kanë kërkuar vizitë, në rast se shpallen fitues dhe gjatë kohës së realizimit të kontratës, paraqesin pretendime që lidhen me terrenin, këto pretendime nuk do të merren në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor.*

- Logjistika dhe shpenzimet e vizitës në objekt do të mbulohen nga Operatori Ekonomik.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. **Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar,** i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF, për Lotin II objekt prokurimi.**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Grafiku i Punimeve: **afati për kryerjen e punimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **sipas materialit bashkëlidhur në PDF**

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

- **Sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF.**

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

